



Datë: 05.08.2025
Numër Protokolli: 5361/2025

A.nr.786/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.780/2025 të datës 30.04.2025 të parashtruar nga ankuesi B.T, me përfaqësues të autorizuar avokat Hajzer Salihu, kundër organit të punësimit/Ministritsë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*transfer*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.08.2025 mori:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.780/2025 e datës 30.04.2025 e parashtruar nga ankuesi B.T.

II. SHFUQIZOHET Vendimi Nr.7781/24 të datës 25.11.2024 i nxjerr nga U.d. Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor metë cilin ka bërë aprovimin e ndryshimeve dhe plotësimit të përshkrimeve të punës të hartuar nga “Grupi i Vlerësimit për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës sipas Vendimit Nr.2338/24 i datës 05.04.2024.

III. SHFUQIZOHET Raporti i Punës dhe Propozimet për Ristrukturim i datës 03.03.2025 për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

IV. SHFUQIZOHEN të gjitha Vendimet dhe procedurat që kanë rrjedhë nga Raporti i Punës dhe propozimet për Ristrukturim në kuadër të MPFI të datës 03.03.2025.

V. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i MMFI-së, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi, të përcaktuar si në pikën **III** të dispozitivit të këtij vendimi.

VI. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

Ar sy e t i m

Nëpunësi civil, B.T (*tani e tutje referuar: ankuesi*), i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me datë 30.04.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është protokolluar me numër: 2888/2025 nën shenjen A.nr.786/2025, kundër Vendimit Nr.336 i datës 18.03.2025 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik DMZP/MPB.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa Këshilli më datë 22.05.2025 ka pranuar nga kjo e fundit përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2888/2025 e parashtruar nga ankuesi më datën 30.04.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 04.04.2025, Vendimin Nr.590 e datës 18.03.2025; Vendimin Nr.2392 të datës 02.12.2024 të DMZP; Vendimin e datës 05.06.2018 Nr. 09/50 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Vendimin e datës 19.02.2020 Nr.04/03 të Qeverisë së Kosovës, Aktgjykimin e GJYKATËS SUPREME P.Anr.07/2025 të datës 10.06.2025 të publikuar në gazetën zyrtare me datë 03.07.2025; shkresën e datës 29.11.2024 nr.7850/24; Vendimin e datës 25.11.2024 të nxjerr nga u.d. Sekretari i Përgjithshëm në MMPHI; emailit të datës 04.10.2024 i dërguar nga I.B i cili ka ushtruar pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në MMPHI dërguar Q.B; emaili i datës 01.11.2024 i dërguar nga A.M, i njëjti ushtronte pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm, dërguar F.I emaili i datës 05.11.2024 të dërguar nga A.M, i njëjti ushtronte pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm dërguar Q.B; emailit të datës 29.11.2024 dërguar u.d. Sekretari Përgjithshëm në MMPHI me të cilën propozon dy anëtar të grupit të ristrukturimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit B.T është **e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara në këtë çështje administrative nga palët respektive në procedurë administrative, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, gjegjësh sipas Akt Emërimit të datës 18.04.2016 (*për kohë të pacaktuar-i përhershëm-karrierës*) i njëjti mbanë pozitën e punës “*Udhëheqës i Divizionit për Pyetës*”, në kuadër të Departamentit/Drejtorinë e Automjeteve-Njësia e Patentë Shoferëve, kurse ndaj të njëjtit Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ka nxjerrë Vendimin me Nr.590 i datës 18.03.2025 përmes të cilit ankuesin e ka transferuar në pozitën “*Udhëheqës i Divizionit për Autorizime dhe Licenca*” në Departamentin e Mbrojtës dhe Rrezatimit dhe Siguri Bërthamore në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, respektivisht DMZP-ja, nxjerrjen e vendimit për transfer sipas detyrës zyrtare e ka mbështetur në Raportin e Punës Nr.191 të datës 03.03.2025 të Komisionit të Ristrukturimit për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Kolegji i Këshillit lidhur me vendosjen e kësaj çështje kontestuese, ka konstatuar se kompetencat dhe detyrat e pozitës së Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor

dhe Infrastrukturës (tutje MMPHI) është ushtruar nga persona të ndryshëm në cilësinë e Ushtruesit të detyrës ose Zëvendëssekretarit të Përgjithshëm duke filluar nga data **07.06.2021** (sipas njoftimit përmes emailit të datës 10.07.2025).

Kolegji i Këshillit me këtë rast ju referua edhe Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik gjegjësisht neni 40 paragrafi 9, 10, dhe 11 ku përcaktohej se “ ***Në rast se procedura e konkurrimit përfundon pa të paktën dy kandidatë fitues të vlerësuar me më shumë se 70 për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, organizohet një procedurë e dytë konkurrimi. Procedura e dytë e konkurrimit është e hapur dhe në të mund të marrë pjesë çdo kandidat, që i plotëson kërkesat e përgjithshme për pranimin në kategorinë e lartë drejtuese dhe kërkesat e posaçme për pozitën përkatëse nga brenda apo jashtë Shërbimit Civil. 10. Në rast se edhe procedura e dytë nuk sjell të paktën dy fitues, një procedurë e tretë konkurrimi, gjithashtu e hapur, organizohet pas një periudhe 3 (tre) mujore. 11. Pas dështimit të procedurës së dytë, deri në plotësimin e pozitës, detyrat e pozitës së lirë kryhen nga nëpunësi i kategorisë së mesme drejtuese me përvojë më të gjatë në Shërbimin Civil të institucionit përkatës.***

Pra sipas kësaj dispozite ligjore që ka qenë në fuqi deri me datë 25.09.2023 kur ligji Nr.06/L-114 është shfuqizuar nga Ligji Nr.08/L197 për Zyrtarët Publikë, Kolegji konstaton se sipas dispozitës së lartshënuar nuk ka pas kufizim kohor lidhur me ushtrimin e pozitës së lartë drejtuese (***Pas dështimit të procedurës së dytë, deri në plotësimin e pozitës, detyrat e pozitës së lirë kryhen nga nëpunësi i kategorisë së mesme drejtuese me përvojë më të gjatë në Shërbimin Civil të institucionit përkatës.***

Ndërsa pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë me datë 25.09.2023, sipas nenit 35 të këtij ligji mbajtja e pozitave më ushtrues detyre rregullohet ndryshe dhe atë si vijon: ***Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit. 3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) mujor, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. 5. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm.”***

Kolegji, rithekson se pozita e Sekretarit të Përgjithshëm në MMPHI nga data 07.06.2021 është mbajtur me zëvendëssekretar apo me ushtrues detyre, me qëllim që vendimi të jetë i kuptueshëm dhe në harmoni me dispozitat ligjore, Kolegji ju ka referua edhe Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, në mënyrë që të jetë e qartë se vendimet e marra nga zëvendësuesi i sekretarit ose ushtruesi i detyrës së sekretarit kanë qenë të ligjshme dhe nuk janë objekt i kontestimit nga ana e Kolegjit në mënyrë **ex Officio**, gjithashtu Kolegji ka parasysh se pozita e Sekretarit të Përgjithshëm në MMPHI edhe sot (datë 04.08.2025, megjithatë Kolegji tani më ka parasysh hyrjen në fuqi të ligjit 08/L-294) ushtrohet nga ushtrues detyre.

Prandaj sa i përket lëndës së ankuesit, Kolegji do të merr parasysh, vendimet dhe veprimet e marra nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI si institucion, si pozitë, dhe jo se cili person e ka ushtruar këtë detyrë këtë e sqaron edhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës P.A.nr.07/2025 i datës 10.06.2025 i publikuar në gazetën zyrtare me datë 03.07.2025

Me datë: **05.04.2024 është nxjerr Vendimi me Nr.2338/24** për themelimin e “Grupi i Vlerësimit për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës”, ky grup kishte për detyrë sipas përshkrimit në vendim të bënte klasifikimin dhe përshkrimin e vendeve të punës në MMPHI, ndërsa me datë 29.11.2024 me nr.239/2024 nënshkruhet Vendimi për Themelimin e Komisionit për Ristrukturim në MMPHI i nënshkruar nga Drejtori i DMZP-së sipas detyrës zyrtare të paraparë në dispozitat ligjore.

Sipas, Kolegjit nga data 26.09.2024 secili veprim që është marrë nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e përshkrimeve të punës është i pa ligjshëm në kuptim të interpretimit të nenit 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, në ndërlidhje me këtë proces Kolegji ju referua emailit të datës 04.10.2024 i dërguar nga I.B i cili ka ushtruar pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në MMPHI dërguar Q.B në të cilin janë përfshi disa zyrtar, citoj emalin “Të nderuar, Ju lutem gjeni të bashkangjitur Formularët e përshkrimit të detyrave të punës për MMPHI” mbyllet emali, gjithashtu Kolegji ju referuar edhe emailave në vijim, emali i datës 01.11.2024 i dërguar nga A.M, i njëjti ushtronte pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm, dërguar F.I ku të përfshirë janë edhe disa zyrtar tjerë, citoj emalin “Të nderuar/a, Më poshtë gjeni: Përgjigjen MMPHI-së në komentet e dhëna nga DMZP në lidhje me përshkrimin e detyrave të punës: Andaj edhe një herë ju lutem shikoni përgjigjet e MMPHI-së dhe gjithashtu ju falënderoj për kontributin dhe punën e bërë sot në takimin që kishim bashku me ju. Po ashtu bëra edhe disa përmisime te fusha e arsimit për Pozitat në Departamentin e Shpronësimit, sepse kishte pasur gabime përmbajtjesore të cilat i keni në fund të emailit. Unë si Sekretar i MMPHI-së jam shumë i interesuar që kjo punë të përfundoj sa ma shpejt edhe për këtë arsye u angazhova në këtë çështje” mbyllet emali me komentet e MMPHI-së, emali i datës 05.11.2024 të dërguar nga A.M, i njëjti ushtronte pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm dërguar Q.B në të cilin emali janë të përfshirë numër i caktuar i zyrtarëve, citoj emalin “Të nderuar/a, Bashkëngjitur gjeni Formularët e Përshkrimit të detyrave të punës për pozitat të cilat janë kthyer nga ana e juaj me komente. Pozitat e bashkëngjitura janë rishikuar dhe ju dërgojmë për rishikim”, mbyllet përshkrimi i emailit. Gjithashtu përmes emailit të datës 29.11.2024 përmes emailit u.d. i Sekretarit të Përgjithshëm në MMPHI cakton dy anëtar të grupit për ristrukturim citoj “***Andaj pas kryerjes së këtyre procedurave, përmes këtij-emali MMPHI, zyrtarisht cakton anëtarët që do të jen pjesë e Komisionit për Rikonstruktim/Sistematizim të vendeve të punës në MMPHI (fjala Rikonstruktim është shkruar kështu në emali po do duhej të ishte ristrukturim). Prandaj pas analizimit të shkresave shihet qartë se DMPZP ka marrë bazë emalin e Ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në MMPHI për themelimin e komisionin të Ristrukturimit, prandaj këto veprime këtë proces e bëjnë të pa ligjshëm.*** Sa i përket këtyre emailo pozita e Sekretarit të Përgjithshëm pos që është ushtruar në kundërshtim me nenin 35 të LZP, përmes emailave shihet se kanë marrë kompetenca të cilat i takojnë grupit punues i themeluar me datë 05.04.2024 me Vendimin Nr.2338/24, këtë veprim të pa ligjshëm sa i përket marrjes së kompetencave e kishte konstatuar Kolegji i Këshillit me vendim A.nr. 598/2025 të datës 26.05.2025.

Kolegji, tërheq vëmendjen se nuk është qëllimi i kësaj vendimmarrje të ndërhyj në përcaktimin e përshkrimit të detyrave dhe përgjegjësi të pozitave të nivelit të mesëm dhe të ultë drejtues të përcaktuara në Rregulloren NR. 08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, sepse nuk është kompetencë e KPMSHCK-së një gjë e tillë, por Kolegji ka shfuqizuar tek përshkrimet e punës të gjitha ndryshimet sa i përket kritereve të kualifikimit dhe detyrave të punës për të gjitha pozitat në MMPHI të cilat janë ndryshuar duke mos ndjekur një qëllim të qartë, legjitim dhe të arsyeshëm dhe aq më tepër të bëra përmes emailave nga ana e pozitës së Sekretarit të Përgjithshëm në MMPHI në kohën kur kjo pozitë është mbajtur në mënyrë të jashtëligjshme me ushtrues detyre apo zëvendëssekretar sikur është arsyetua në këtë vendim.

Në kontestin e lartshënuar, Kolegji ju referua edhe Ligji nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura gjegjësisht nenit 18 paragrafi 1, 2, 3, nën paragrafi 3.1, 3.2, 3.4, 3.5, 3.6 dhe 3.7 ku përcaktohet se” Sekretari i Përgjithshëm 1. *Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil i ministrisë, përgjegjës për drejtimin e të gjithë veprimtarisë administrativo-profesionale të sistemit ministror.* 2. *Sekretari i Përgjithshëm i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt ministrit dhe ushtron detyrën nën drejtimin dhe udhëzimet e ministrit.* 3. *Sekretari i Përgjithshëm ka këto përgjegjësi kryesore: 3.1. mbështet ministrin në punën e tij; 3.2. siguron koordinimin e hartimit të politikave në ministrinë përkatëse; 3.3. siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit, të politikave dhe të vendimeve të ministrit; 3.4. siguron drejtimin, koordinimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e të gjithë sistemit ministror; 3.5. siguron bashkëpunimin me ministri të tjera dhe institucionet, si dhe me agjencitë e pavarura; 3.6. vendos për administrimin e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore, të sistemit ministror, në përputhje me legjislacionin në fuqi; 3.7. çdo përgjegjësi tjetër, që i caktohet me ligj apo të deleguar shprehimisht nga ministri”.* Nisur nga kjo dispozite i gjithë procesi i ndryshimit dhe plotësimit të përshkrimeve të punës është kryer në kohën kur pozita e Sekretarit të Përgjithshëm është mbajtur jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 35 të LZP gjithashtu raporti i ristrukturimit në MMPHI është përfunduar në këtë kohë, Kolegji ka parasysh se Vendimin për Ristrukturim e ka nënshkruar drejtori i DMZP-së, por kjo e fundit nuk mundet të vihet në lëvizje pa propozimin e institucionit që i nënshtrohet ristrukturimit, prandaj si rrjedhojë këtë proces e bënë të pa ligjshëm çdo veprim i ndërmarrur nga ana e ushtruesit e detyrës apo zëvendëssekretarit, si dhe çdo zyrtar që është propozuar të merre pjesë në këtë proces nga ana e pozitës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI e cila pozitë pas datës 26.09.2024 sipas interpretimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës është mbajtur e pa plotësuar në mënyrë të pa ligjshme dhe jashtë afateve të parapara në nenin 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Në këtë kontest dhe sa u tha më lartë Kolegji ka marrë parasysh Aktgjykimin e Gjykatës Supreme P.A.nr.07/2025 i datës 10.06.2025 i publikuar në gazetën zyrtare me datë 03.07.2025 i cili në faqen 10 të tij ka trajtuar nenin 35 të Ligjit Nr.08/L-198 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet si vijon: Neni 35 Ushtruesja/i e/i detyrës 1. *Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë.* 2. *Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit.* 3. *Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë.* 4. *Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni.* 5. *Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm.”*

Gjykata Suprem konstaton se “Nga kjo dispozite rrjedhë qartë se çdo akt juridik i nxjerrë nga një udhëheqës në cilësinë e ushtruesit të detyrës pas skadimit të afatit prej një viti është i pavlefshëm në thelb, për shkak të mungesës së kompetencës ligjore për të ushtruar funksionet që burojnë nga ajo pozitë..., Ligji i referohet pozitës si funksion institucional dhe jo individit si person. Pra ndërrimi i personit nuk e dhe nuk e rifillon afatin gjashtëmuajor, përkatësisht njëvjeçar të ushtrimit të përkohshëm të pozitës. Kjo qasje është në përputhje me frymën e ligjit që kërkon, stabilitet, profesionalizëm dhe përgjegjësi në udhëheqjen publike..., Gjykata konstaton se pretendimet e palës paditëse për tejkalim afati janë të bazuar në dispozitat eksplicite ligjore dhe kanë për qëllim mbrojtjen e legjitimitetit të aktit dhe sigurinë juridike në funksionimin e institucioneve.

Respektimi i Kufizimeve kohore është thelbësore për funksionimin ligjor dhe transparent të institucioneve publike. Çdo shkelje e këtyre normave sjell pasoja negative në zbatimin e drejtë të ligjit dhe mund të krijojë precedent të dëmshëm. Kështu, pretendimet e palës paditëse gjejnë mbështetje në parimet e ligjshmërisë dhe rendit kushtetues, të cilat i mbështet dhe i konstaton edhe gjykata.

Prandaj në këtë kontest meqenëse Aktgjykimet e Gjykatave janë të obliguar për të gjithë subjektet e së drejtës, nisur nga neni 101 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku përcaktohet se “ **Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës**”, si dhe Gjykata Supreme gjatë shkrimit të aktgjykimit ka shkruar në trajtën e shumës që do të thotë se aktgjykimi nuk rregullon kontestin vetëm në mesë palës paditës dhe të paditurës (palë paditës nëpunësit të Autoritetit të Aviacionit civil e paditura AAC), por gjen shprehje në të gjitha institucionet që zbatojnë Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Kolegji i Këshillit rithekson faktin se institucionet e administratës publike janë të obliguar ta zbatojnë Ligjin Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme për aq sa nuk është e rregulluar ndonjë procedurë me ligj të veçanta (në rastin konkret çështja është e përcaktuar në nenin 35 të LZP), por si rrjedhojë këtu Kolegji mbështet në këtë ligj me qëllim të konstatimit se kjo procedurë është e pa ligjshme ndërlidhur me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.7 ku përcaktohet se” Paligjshmëria e aktit administrativ 1. ***Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo 1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit.***

Gjithashtu Kolegji në këtë rast, pasi që ka shfuqizuar një proces të tërë në MMPHI ka marrë për bazë edhe nenin 58 paragrafin 1 dhe 2 të ligjit të lartshënuar ku përcaktohet se” Afati për anulimin dhe shfuqizimin 1. ***Anulimi në rastin e paraparë nga neni 55 i këtij Ligji si dhe shfuqizimi në rastin e paraparë nga paragrafi 1 i nenit 57 të këtij Ligji, mund të bëhet në çdo kohë. 2. Anulimi apo shfuqizimi, në çdo rast tjetër mund të bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur organi publik i përcaktuar sipas paragrafit 1 të nenit 53 të këtij Ligji, njihet me faktet që justifikojnë anulimin apo shfuqizimin, por jo me vonë se pesë (5) vjet nga njoftimi i aktit administrativ***”.

Kolegji i Këshillit lidhur me këtë vendimmarrje ka pasur parasysh edhe Ligjin e Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative gjegjësisht nenin 8 ku përcaktohet se “ ***Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme 1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave. 2. Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme***”, prandaj ndryshimi i vendim marrjes lidhur me këtë çështje nga ana e Kolegjit të Këshillit ndërlidhet drejtpërdrejtë me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Anr.07/2025 të datës 10.06.2025 të publikuar në gazetën zyrtare me datë 03.07.2025.

Prandaj nga të lartëthekësuarat sikur në arsyetim të këtij vendimi, Kolegji në mënyrë **ex officio**, ka marrë për bazë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Anr.07/2025 të datës 10.06.2025 dhe me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, nisur nga fakti që numër i madh i nëpunësve civil kanë parashtruar ankesa

në KPMSHCK dhe nga trajtimi i tyre Kolegji ka konstatuar se ka shkelje të dispozitave materiale dhe procedurale gjatë ndryshimit dhe plotësimit të përshkrimeve të punës, si gjatë ristrukturimit të punësuarave në MMPHI, Kolegji vendosi që të shfuqizoj të gjitha ndryshimet e përshkrimeve të punës të bëra nga Grupi i Vlerësimit për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si dhe Raporti i Punës dhe Propozimet për ristrukturim në MMPHI të datës 03.03.2025.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/l-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS LËNDA, A.NR.786/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit avokatit Hajzer Salihu;
- Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (*Sekretarit të Përgjithshëm, Komisionit të Ristrukturimit dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore*),
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.